



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLIKA KOSOVA



## KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI KOMUNAL PEJË

I.Numër:060/01-14386

Pejë, datë: 06.Nëntor 2018.



### PROCESVERBAL

Nga takimi i Jashtëzakonshëm i Kuvendit Komunal Pejë, dt.06.Nentor 2018, i caktuar me kërkesën e bërë me shkrim nga anëtari dr.sc.Reshat Nurboja, dhe të nënshkruar nga 1/3 e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kuvendit të komunës.

Takimi u mbajt në sallën e takimeve të Kuvendit Komunal Pejë.

Në takim prezantojnë: pos anëtarëve të kuvendit, drejtori i DBF-ca z.Jeton Abazaj, ZIP, përfaqësuesit e OSBE-së, OJQ-ve, mjeteve të informimit publik, TV. " Dukagjini " dhe qytetarët e interesuar.

Takimin e hapi dhe e kryesoi, kryesuesi i kuvendit komunal dr. Islam Husaj, me rendin e propozuar të ditës si vijon.

### Rendi i Dites

(1) "SHQYRTIMI I MBI 100 DENIMEVE TË KOMUNËS SË PEJËS NGA GJYKATAT E KOSOVËS NË VLERË MBI TRE MILION EURO...!"

(Ky është teksti i propozuar për rend dite me shkresën 01.Nr.060/01-112605, dt.03.09.2018, nga këshilltari z.Reshat Nurboja, për mbajtje të seancës së jashtëzakonshme të KK.Pejë dhe i nënshkruar nga 14 këshilltar Komunal.)

Kryesuesi fillmisht kërkoi nga të pranishmit që me vendosjen e kartelave të konfirmojnë pjesëmarrjen në këtë takim të jashtëzakonshëm të kuvendit komunal me qellim të konstatimit të kuorumit për mbajtjen e këtij takimi.

Kryesuesi dr.Islam Husaj, konstatoi se: në këtë takim prezantojnë 14 anëtarë të kuvendit komunal nga gjithseit 35 anëtarë të kuvendit, (mungojnë 21 anëtarë) dhe se nuk ka kuorum për mbajtjen këtij takimi.

Kryesuesi dr.Islam Husaj, dha një pauzë prej gjusmë ore, për të pritur se mos vijnë anëtarët e kuvendit për ta bërë kuorumin për mbajtjen e seancës.

Mbas pauzës prej 30 minutash, kryesuesi dr.Islam Husaj, serish kërkoi nga anëtarët e kuvendit komunal që me vendosjen e kartelave të konfirmojn pjesëmarjen në këtë takim.

U konstatua se në takim serish prezentojn 14 anëtarë të kuvendit komunal, se mungojnë 21 anëtarë të kuvendit dhe konstatoi se: nuk ka kushte për mbajtjen e kësaj seance në mungesë kuorumi.

Andaj, vendosi që seanca të shtyhet për një kohë të pacaktuar, kur të sigurohet kuorumi.

Mëqë, munguan kushtet ligjore për mbajtjen e kësaj seance të jashtëzakonshme, kryesuesi dr.Islam Husaj, e shpalli të mbyllur këtë takim në orën 10,35h.

Procesmbajtësi  
Ilir Thaqi



K R Y E S U E S I ,  
Dr.Islam Husaj